



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Br. Stranica NoPages	04
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No	2675-3/24
Data Datum Date	02.06.25
PRISHTINË / A	
No 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.05.2025
REFERENC-Ë:	2675-2/24 ZSP - 2024
PËR/ZA/TO:	Drejtorja Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, K.Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtori ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e lartë , ARPL
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pëlqim ujq

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në kërkesën me Nr. Protok. 2675-2/24, datë 11.07.2024 të palës, Drejtorja Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, K.Pejë, lidhur me projektin "Pastrimi - Rehabilitimi i shtratit të Lumbardhit -Ramun - Gllaviqicë", dhe pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planing and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. PU

Datë: 23.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, U.A. MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa për **Pëlqim Ujor** për palën, “Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim” K. Pejë, me nr. Protok. 2675-2/24, për projektin “Rehabilitimi i shtratit të Lumit Lumbardhë i Pejës nga Penda në fsh Ramun e gjërë tek ura e Fsh. Gllaviqicë” K. Pejë.

Pëlqimi Ujor lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, bazuar në pikat gjeodezike, në distancë L=1.600 km, nga Ura në fsh. Gllaviqicë me pika me koordinata (X=7 452 099.055; Y=4 721 612.965), P-71311018-00304-2 dhe pika e mbarimit deri tek Penda e fshatit Ramun (X=7 514 871.20; Y= 4 680 823.87), parcela me P-71611077-00175-0; si dhe bazuar në profilet karakteristike tërrthore të Lumit, sipas llogarive, si pjesë përbërëse e dokumentacionit në bazë të së cilave është hartuar vendimi, andaj si i tillë ruhet nga pala, nën kushtet si në vijim;

1. Pastrimi i lumit Lumbardh i Pejës, të relizohet sipas projektit, në gjatësin L = 1.600 km, të hartuar nga kompania “Dakaj M’ sh.p.k. , me të cilën kompani K. Pejë, ka rënë në ujdj për pastrimin e lumit;
2. Pëlqimi ujur për nxjerrjen e materialit nga ujërrjedha, vlen vetëm për vitin aktual në të cilin është lëshuar pëlqimi ujur, respektivisht me dinamikat nga elaborati për nxjerrjen e materialit nga ujërrjedha, sipas projektit;

3. Kërkesa e mirëmbajtes nuk mund të jet afatgjate, pëlqimi ujon ka afat një vjeçar, dhe pas kalimit të kësaj periudhe kohore, pala duhet të bëjë kërkesë të veçant, po që se paraqitet nevoja, sepse aktualisht me legjislacionin në fuqi nuk parashihet ndryshe;
4. Pëlqimi ujon për nxjerrjen e materialit ndërpritet edhe para afatit të përcaktuar nga paragrafi si më sipër, nëse gjatë kontrollit nga inspektorati i ujërave komunal dhe qendrorë, vërtetohet se kryesi i punëve nuk iu është përmbajtur kushteve të përcaktuara me pëlqim ujon;
5. Dinamika e nxjerrejs së materialit, dhe rehabilitimi pas këtijë aktiviteti të prezantohet në formë ditari për secilin segment, të raportohet në MMPHI;
6. Raportet duhet të jenë të nënshkuara dhe me datë, në ditën kur janë kontrolluar nga organi mbikqyrës i Komunës së Pejës;
7. Vendi për deponimin e materialit, duhet të jet i caktuar, dhe me prezantim të ngastrës së paraparë dhe për çdo ndryshim pala duhet ta informoj Organin i cili e ka lëshuar këtë Pëlqim Ujon;
8. Pala detyrohet që të bëjë inçizimin gjeodezik të shtratit të segmentit të lumit të pastruar, pas kryerjes së punimeve dhe të njëjtin ta prezantojë pranë Organit që e ka lëshuar Pëlqimin ujon;
9. Pastrimi i drrunjëve duhet të kryhet në harmoni me pëlqim nga organi përgjegjes e që është ministria përkatëse e pylltarisë;
10. Punëkryesi i detyrohet MMPHI-së, që materialin ranor dhe gurorë të larguar ta prezantojë realisht si dhe vendëndodhjen pranë organit përgjegjës që e ka lëshuar këtë Pëlqim ujon, për shkak të vlerësimit financiar, sipas U.A për strukturën e pagesave në fuqi, kur nxjerret material i karakterit rërë, zhavorr dhe Gurr;

ARSYETIM

Pala, Komuna e Pejës – Drejtoria Komunale për mbrojtje dhe shpëtim, ka aplikua për Pëlqim Ujon, lidhur me “Pastrimi – Rehabilitimi i shtratit të Lumbardhit – Ramun – Gllaviqicë”. Kërkesës ia ka bashkangjitur dokumentacionin e dorëzuar si në vijim: Projekt i Rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardh i Pejës nga “Penda e Fsh . Ramun e gjerë te Ura e fshatit Glaviqicë “, me prerjet e profileve tërthore çdo 50m, K. Pejë Certifikata e pronësisë për (P-71611018-00304-1; P-71611016-00154-1; P-71611016-00113-1; P-71611077-00175-0; P- 71611074-00365-0) P. Sh.U; Plani i situacionit për ngas. P-71611077-00175-0, ZK Romune , ZK Gllaviqicë; Z.K.Vragoc, punuar nga person i licencuar nr. 7 ; Driton Shllaku, kompania “ Geo Kad” sh.p.k.; Certifikata e Regjistrimit të biznesit të Kompanisë hartuese; Pagesa me vlerë 100 euro gjatë aplikimit; Sh.p.k. Deklarimi i hartuesit të projektit; : Certifikata e regjistrimit të “Geo –Kad” sh.p.k.; Kërkesën e palëve për mbrojtjen e tokave nga Miftar Miftari, Tahir Hysenaj dhe Lan Musaj; Kërkesën e bërë nga Udhëheqes i sektorit për siguri dhe emergjenca për palet në fjalë, nënshkuar dhe vulosur nga K. Përkatëse. Fotografi të prezantuara për segmentin e paraparë për pastrim CD-ja; Ortofoto e gjendjes aktuale, si dhe me rregullimin e paraparë etj. Kompania hartuese ka bashkangjitur edhe diplomën e Z. Shkelzen Ahmet Rexha, inxhinier i diplomuar , si dhe orofoto me lumin e paraparë të pastruar.

Vërejtje: Ky projekt do të realizohet, me qëllim të mbrojtjes së regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit, dhe mbrojtjes nga permbytjet si dhe nxjerrja e rërës, zhavorrit, dhe gurëve, nga trupat ujqor sipërfaqësorë në segmente të caktuara.

- Për nxjerrjen e materialeve nga ujërrjedha, e cila përfshin largimin dhe nxjerrjen e inerteve të formuara në brigje dhe shtrat të lumit, në procesin e leshimit të akteve ujore, organi kompetent, vendos mbi ekzistimin e nevojës dhe kushteve për nxjerrjen e materialit në segmentin konkret të ujërrjedhës;
- Deri në aprovimin e Planit për menaxhimi e pellgut lumor, nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurëve nga trupi ujqor sipërfaqësorë, kjo çështje zgjidhet me vendim nga Ministria;
- Nëse vie deri te prishja e regjimit të ujërrjedhës, ose i shkaktohet dam palës së tretë gjatë realizimit të punimeve, punkryesi detyrohet që dëmet ti eliminoj dhe të njejtat ti kompenzoj;

Punëkryesi ka kryer:

“Projekti i rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardh i Pejës nga Penda e fsh. Ramun e gjërë te Ura e fsh . Gllaviqicë” K. Pejë, Incizimi gjeodezik i situacionit, profilet tërthore çdo 50 m etj:

Verejtje : Bazuar në pronocimin e drejtorit, duke u bazuar në takimet që kemi pasur dhe informatat faktike që ju kan ofruar nga unë si zyrtare përgjegjëse, si dhe sqarimin që ka bërë udhëheqësja e DMRU-së, lëndët janë procesuar për nënshkrim, si dhe lenda e proceduar për nënshkrim me 20.11.2024 në ZSP nga ARPL-ja. Andaj bazuar në kërkesën e K. Pejë, dokumentacionit – investivo teknik të hartuar, si dhe interesimin që ka shprehë Komuna për rregullim të gjendjes, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. 2675-2/24 – ZSP - 2024 Datë: 23.05.2025

Prishtinë

T’i dërgohet:

- Komunës Pejë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Izedin BYTYQI